



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.541/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Adnan Konushevi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Gentiana Krasniqi duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga **Imer Ademaj** nga Austria, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 27.08.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet i pabazuar** apeli Anr.541/2021 i paraqitur nga **Imer Ademaj** nga Austria, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021.

## A r s y e t i m

Me datën 26.08.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga **Imer Ademaj** nga Austria në të cilën pretendohet se të njëjtit i është refuzuar kërkesa për tu regjistruar si votues jashtë Kosovës edhe pse me datë 16.08.2021 ka aplikuar për regjistrim votimi përmes postës, në të cilin aplikim ka dëgjuar aplikacionin së bashku me pasaportë me afat të skaduar ngase nuk e kishte me afat të rregulltë dhe se vet informimi ka qenë se mund të aplikojë edhe me dokument me afat të skaduar.

Parashtruesi i apelit krahas apelit ka bashkangjitur pasaportën me afat të skaduar, dokumentin valid, lejen e vozitjes si dhe aplikimin e datës 16.08.2021.

Me datë 27.08.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ për ankesën A.nr.541/2021 të parashtruar nga Imer Ademaj me të cilën ka kërkuar që KQZ të përgjigjet lidhur me kërkesën deri me datë 27.08.2021 ora 16:00.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve KQZ, brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën theksohet se parashtruesi i ankesës Imer Ademaj së bashku me aplikacionin e regjistrimit e ka dërguar pasaportën e Republikës së Kosovës me afat të skaduar me të cilin dokument nuk dëshmohet identiteti.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

### Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës, nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: *“çdo person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës”*, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: *“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil”* dhe dispozita e nenit 3.3 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se:

3.3 Personi i cili ka për qëllim të hedhë votën për Votim Jashtë Kosovës...do të regjistrohet në KQZ si votues jashtë Kosovës duke dorëzuar:

a) formularin për Aplikim/Regjistrim për votim jashtë Kosovës, kopja e së cilës është bashkangjitur si Shtojcë II, dhe,

b) dëshminë e dokumentacionit të identitetit dhe që ai ose ajo i plotëson kriteret ligjore për të drejtën për të votuar në pajtim me nenin e LZP-së dhe të bashkangjiten dokumentet e fotokopjuara siç janë të renditura në Shtojcën III. të kësaj rregulle,

Nga shkresat e lëndës, si dhe nga përgjigja e KQZ-se, Paneli vlerësoi se parashtruesi i apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës dosja e tij nuk ka qenë e kompletuar ngase edhe pse i njëjti ka bashkangjitur pasaportën me afat të skaduar e njëjta nuk mund t'i merret si kriter për pranim për tu regjistruar si votues jashtë Kosove ngase me Vendimin nr. 1948-2021 i datës 12.08.2021 theksohet se si rezultat i mos prodhimit të dokumenteve të identifikimit letërnjoftimit, Ministri i Punëve të Brendshme, me datë 14.07.2021 ka marrë vendim që “të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës, pavarësisht afatit të skadimit të vlefshmërisë së letërnjoftimit, etërnjoftimi i tyre konsiderohet i vlefshëm edhe pr gjashtë (6) muaj me hyrjen në fuqi të këtij vendimi si dhe mund ta përdorin për kryerjen e shërbimeve në institucionet publie dhe private, brenda Republikës së Kosovës” e cila vlen specifikisht për letërnjoftimin e jo edhe për pasaportën e që në këtë rast konsiderohet dokument jovalid prandaj edhe i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç parashihet me dispozitat e nenit 5.1 pika a) të LZP-së dhe të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara, andaj me të drejt është refuzuar nga ana e KQZ-së.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 541/2021 më datën 27.08.2021

**Kryesuesi i Panelit**

**Faton Ademi**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.

